

DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË  
LIDHEN ME AGJENCINË  
KOSOVARE TË  
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE  
SUPREME COURT OF KOSOVO  
ON KOSOVO TRUST AGENCY  
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU AGENCIJU

**ASC -09-0059**

Në padinë e

*Paditësit/Ankuesit*

1. [REDACTED] Prishtinë  
2. [REDACTED] Prishtinë  
të përfaqësuar nga [REDACTED]  
Avokat nga Prishtina  
Rr. [REDACTED]

vs.

*E Paditura*

[REDACTED]  
Ndërmarrje Shoqërore  
Rr. [REDACTED] Prishtinë  
  
e përfaqësuar nga [REDACTED]  
Avokat nga Prishtina  
Rr. [REDACTED]

Kolegji per Ankesa pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 3 qershor 2010 lëshon këtë:

**AKTVENDIM**

- 1. Ankesa është e bazuar.**
- 2. Vendimi i Trupit Gjykues (SCC-08-0245) i datës 26 gusht 2009 anulohet.**
- 3. Lënda kthehet tek Trupi Gjykues për rigjykim.**
- 4. Ankuesit - paraprakisht -obligohen që ti paguajnë bashkërisht taksat gjyqësore në shumë prej 60 Euro në Dhomën e Posaçme.**

**Rrethanat procedurale:**

Më 7 gusht 2008, Paditësit kanë ushtruar padi pranë DHPGJS-së duke kërkuar që të vërtetohet se Paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë dhe të shfrytëzimit të përherershëm të gjysmës së ish-ngastrës kadastrale [REDACTED] fleta poseduese [REDACTED] Komuna e Prishtinës, me sipërfaqe prej [REDACTED] metra katror, tani e regjistruar me numër të ri të Parcelës [REDACTED] [REDACTED] dhe ta obligojë të Padituren ta njeh dhe t'ia sigurojë dokumentacionin e nevojshëm për bartjen e të drejtave pronësore dhe regjistrimin e saj në emër të Paditësve. Në padinë e tyre të plotësuar të datës 22 dhjetor 2008, Paditësit tregojnë se paraardhësit e tyre e kanë blerë tokën e kontestuar dhe se nga ajo kohë ngastra tokësore ka qenë në posedim të vetëdijshëm dhe të pandërprerë për 42 vjet, kështu që Paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim. Gjithashtu, në përgjigjen e tyre të datës 26 dhjetor 2008, Paditësit edhe një herë kanë cekur se ata e kaun fituar të drejtën e pronësisë në bazë të parashkrimit, konform Nenit 28 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore të Pronës.

Me vendimin e saj të kundërshtuar, SCC-08-0245, të datës 26 gusht 2009, Trupi Gjykues e ka refuzuar padinë si të papranueshme konform Nenit 28.1 lidhur me Nenin 28.3 të Udhëzimit Administrativ (UA) të UNMIK-ut 2008/6, mbi bazën se DHPGJS-ja nuk ka kompetencë mbi padinë, meqë çështja është në kompetencë të organeve administrative sipas dispozitave të Ligjit mbi

Shpronësimin (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 21/28 me ndryshime). Trupi Gjykues i është referuar Nenit 40 të Ligjit mbi Shpronësimin e Pasurive të Paluajtshme (Ligji Nr. 03/L-139) i cili parashev se procedurat e shpronësimit që kanë filluar para hyrjes në fuqi të ligjit në fjalë do të drejtohen me dispozitat e ligjit në zbatim në ditën kur ato procedura kanë filluar, pra duke zbatuar Ligjin mbi Shpronësimin. Gjithashtu, Trupi Gjykues ka ardhur në përfundim se kthimi i pronës i vendosur me vendim përfundimtar të organit administrativ nuk mund të procedohet me procedurë civile kontestimore sepse ky vendim sipas ligjit bie në kompetencë të administratës. "Vendimmarrja, ankesa, si dhe anulimi i vendimit mbi shpronësim në kompetencë të organit administrativ." Trupi gjykues fare nuk e përmend çështjen e parashkrimit në arsyetimin e tij.

Më 18 shtator 2009, Paditësit kanë paraqitur një ankesë kundër vendimit të lart-përmendur, duke kërkuar nga Kolegji për ankesa të DHPGJS-së që ta ndryshojë vendimin dhe t'ia vërtetojë Paditësit të drejtat e pronësisë, ose që ta anulojë vendimin dhe ta kthejë lëndën Trupit Gjykues për rigjykim. Paditësit argumentojnë se DHPGJS-ja ka kompetencë parësore për të gjitha paditë kundër ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe publike, të cilat aktualisht janë nën kompetencë administruese të Agjencisë.

Në përgjigjen e saj ndaj ankesës, e Paditura propozon që të refuzohet ankesa e Paditësit dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar. Më tej ajo cekë se procedura e shpronësimit ka përfunduar nga organet komunale të Prishtinës.

### **Arsyetimi Ligjor:**

Ankimi është i pranueshëm dhe i bazuar. DHPGJS-ja ka kompetencë lëndore për padinë e Paditësit.

### *Kompetenca lëndore e DHPGJS-së për padinë e Paditësit*

Pa paragjykuar arsyetimet në vijim mbi kompetencën themelore të DHPGJS-së lidhur me padinë e tërë, DHPGJS-ja do të kishte në çdo rast kompetencë për padinë, së paku sa i përket bazës ligjore të supozuar mbi parashkrimin sipas Nenit 28 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Thelbësore Pronësore. Kjo çështje juridikisht nuk lidhet me çështjen e vlefshmërisë së akteve të kontestuara të shpronësimit dhe kështu ato mund të rishqyrtohen nga DHPGJS-ja edhe sikur argumentimi i Trupit Gjykues lidhur me kompetencën e DHPGJS-së sa i përket akteve administrative të shpronësimit të ishte i drejtë. Trupi Gjykues, në vendimin e tij, nuk ka marrë parasysh se kompetenca lëndore e ndonjë gjykate mund të përcaktohet nga baza ligjore në të cilat padia thirret. Mund të ketë argumente të ndryshme ligjore të cilat të gjitha mund të shpijnë tek i njëjtë efekt i dëshiruar nga paditësi, por që bie në kompetencë të gjykatave të ndryshme. Në rastin konkret, Paditësit e kanë bazuar padinë e tyre kryesisht mbi parimin ligjor të parashkrimit. dhe se vetëm në vazhdim e ka bazuar atë mbi siç thuhet paligjshmërinë e vet shpronësimit.

Gjithashtu lidhur me kompetencën e DHPGJS-së sa i përket akteve të shpronësimit, argumentimi i Trupit Gjykues nuk mund të kuptohet. Është në kompetencë të DHPGJS-së që ta shqyrtojë vlefshmërinë e ndonjë akti të shpronësimit e cila kontestohej me padi kundër ndonjë ndërmarrje në pronësi shoqërore apo publike.

E Paditura është Ndërmarrje Publike (NP). Sipas Nenit 4, pika c e Rregullores (RREG) së UNMIK-ut 2008/4 Trupi Gjykues i DHPGJS-së ka kompetencë parësore për (të gjitha) paditë dhe kundërpaditë të lidhura me paditë duke përfshirë paditë kreditore dhe ato pronësore të paraqitura kundër ndonjë

#### IV

ndërmarrje apo korporate, tani apo më parë nën kompetencën administrative të Agjencisë, nëse ato padi kanë dalë gjatë apo para asaj kohe kur ajo ndërmarrje apo korporatë është apo ka qenë në vartësi të kompetencës administrative të Agjencisë. Sipas Nenit 5.1 të RREG së UNMIK-ut 2002/12 Agjencia ka kompetencë që ti administroi ndërmarrjet publike të cilat janë regjistruar apo funksionojnë në territorin e Kosovës. Konform Neneve 4.1 , pika c) të RREG së UNMIK-ut 2008/4 dhe 5.1 TË RREG së UNMIK-ut 2001/12, DHPGJS-ja ka kompetencë parësore për padinë e Paditësve.

DHPGJS, gjatë vendosjes mbi padinë e paditësit, gjithashtu mund të vlerësojë se cili është validiteti ligjor i një vendimi të mëhershëm të organit administrativ, e poashtu edhe validitetin e aktvendimeve apo aktgjykimeve të gjykatës, të cilat mund të kenë peshë ligjore në çështje, pra duke e përcaktuar nivelin e fuqisë ligjore të aktvendimit të mëhershëm. Edhe po qe se Trupi Gjykues edhe gabimisht të vinte në përfundim, se vendimi mbi shpronësimin i marrë nga administrata ka qenë ligjërisht ekzekutiv dhe kështu e ka përcaktuar gjendjen e ngastrës në fjalë sa i përket çështjes së pronësisë, ky do të ishte vendim mbi meritën, e jo vendim mbi pranueshmërinë.

Pos kësaj,shmangia nga ushtrimi i kompetencës mbi lëndët sikurse kjo do ti linte ata që iu kanë nënshtuar akteve të shpronësimit para vitit 1999 pa ndonjë mjet të duhur ligjor. Mund të pretendohet se aktet e shpronësimit mund të kenë qenë të lidhura me diskriminimin para vitit 1999. Kjo duhet të shqyrtohen në baza të secilës lëndë veç e veç dhe poashtu duhet të shqyrtohet se nëse ata persona prona e së cilëve ka qenë lëndë e shpronësimit edhe atëherë kanë patur mjete të duhura – në suaza të ligjit të zbatueshëm në atë kohë - për ti paraqitur kundërshtimet e tyre kundër shpronësimit. Për momentin, ligji i zbatueshëm në Kosovë nuk e parashev

mjetin e duhur ligjor për ti kundërshtuar ato shpronësime jashtë gjykatave të rregullta, duke përfshirë këtu edhe DHPGJS-në. Në bazë të këtyre vlerësimeve, Kolegji i Ankimeve nuk sheh ndonjë arsy që ti shmanget nga formulimi i qartë i -pa ndonjë çështje të aplikueshme -dispositave të RREG së UNMIK-ut 2008/4 e cila i jep kompetencë DHPGJS-në për të gjitha paditë e paraqitura kundër ndonjë NSH-je apo NP-je, pa marrë parasysh natyrën e tyre ligjore.

Përveç kësaj, duhet përmendur se Trupi Gjykues nuk ka dhënë arsyetim për supozimet e tij se "Ligji mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme" (Ligji Nr. 03/L-139) është i zbatueshëm në Kosovë. Pos mungesës së këtij arsyetimi ligjor ( shih Nenin 9.3 pika (b) e RREG së UNMIK-ut 2008/4 dhe Nenin 48.1 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6) përfundimin të cilin Trupi Gjykues e ka nxjerrë nga zbatimi i supozuar i atij ligji është poashtu i pabazuar; Kur është bërë shpronësimi në fjalë, Ligji mbi Shpronësimin (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 21/78, me ndryshime) nuk ka qenë ende në zbatim.

V

#### *Kthimi i lëndës në rigjykim*

Duke pasur parasysh se Trupi Gjykues vetëm ka vendosur për pranueshmërinë e padisë dhe se sipas Nenit 65, pika c të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 – për të mos ua mohuar Paditësve qasjen në të dy instancat e plota – lënda duhet të kthehet tek Trupi Gjykues për rigjykim. Trupi Gjykues do ta ndjek mendimin ligjor të Kolegjit për Ankesa dhe do të përbahet nga hedhja poshtë e padisë edhe një herë për të njëjtat shkaqe.

## Taksat Gjyqësore

Në bazë të Nenit 11 të RREG 2008/4 dhe Nenit 66 të UA-së së UNMIK-ut 20078/6, Trupi Gjykues duhet të vendosë në caktimin e shpenzimeve të procedurës në shkallën e parë, dhe se Kolegji i Ankimeve – kur ta vendosë lëndën përfundimisht - rrëth caktimit të shpenzimeve të procedurës në të dyja shkallët. Lënda konkrete duhet të rigjykohet në shkallën e parë; andaj vendimi final për caktimin e shpenzimeve për momentin nuk mund të merret, sepse caktimi varet nga vendimi i ardhshëm i Trupit Gjykues. Tash për tash vetëm shuma e shpenzimeve mund të përcaktohet në shkallën e dytë, duke marrë parasysh se as në shkallën e parë e as në shkallën e dytë nuk janë prezantuar faktet apo deklaratat të cilat do të lejonin përcaktimin e vlerës së padisë. Andaj, në pajtim me shembujt e dhëna nga Kolegji për Ankesa (shih p.sh. ASC-100024 dhe ASC-090072, 29 PRILL 2010), aplikohen këto tarifa gjyqësore për procedurën ankimore:

|   |         |
|---|---------|
| Tarifa Gjyqësore, Neni 10.11 (ushtrimi i ankesës) | 30 Euro |
| Tarifa Gjyqësore, Neni 10.15 lidhur me            |         |
| 10.21 dhe 10.1 ( vendimi në shkallën e parë)      | 30 Euro |
| Gjithsej  | 60 Euro |

Shpenzimet gjyqësore paraprakisht barten nga Ankuesit.

|  |              |
|--|--------------|
| Richard Winkelhorf, Gjyqtar Kryesues,EULEX | (nënshkruar) |
| Torsten Koschinka, Gjyqtar, EULEX          | (nënshkruar) |
| Elija-Liisa Helin, Gjyqtare, EULEX         | (nënshkruar) |
| Tobias Lapke, Regjistrues, EULEX           | (nënshkruar) |